

## **Çka është grupi i lojës?**

Në grupin e lojës apo si e quajnë këtu Spielgruppe, takohen fëmijët dy vite para se të fillojnë në parashkollore. Takimet janë një ose më shumë herë në javë. Një grup përmban 8 deri maksimalisht 12 fëmijë. Fëmijët mësojnë sjelljen sociale në grupe të vogla dhe fitojnë përvojat e tyre, shpesh për herë të parë pa prindërit e tyre. Dhe e gjithë kjo përvojë bëhet përmes lojës. Në grup fëmijët janë nën përkujdesje, të sfiduar, të mbështetur dhe të përkrahur. Ata mund të luajnë të lirë, pa e pasur nevojë të përmbushin një detyrë.

Grupet e lojrave kanë detyrën e formimit të një ishulli për fëmijë. Ishull ky që përforcon ndjenjat e mira të tyre.

Në qendër të grupit të lojës është fëmija para parashkollorës me dëshirat për të luajtur, lëvizur, shprehje por edhe për qetësi. Përmes grupit të lojës fëmija e zgjerojë fushën e tij të veprimtarisë dhe rjetin e tij social.

Në këtë mënyrë fëmija mëson të zë një vend në grup, mëson ta thotë mendimin e vet por edhe të jetë i vëmendshëm ndaj tjerëve, mëson të i pranojë pikat e forta dhe të dobëta të njëri tjetrit, mëson të ju ndihmojë dhe ndëgjojë të tjerët, poashtu ndonjëherë edhe të hidhërohen por edhe të pajtohen me njëri tjetrin. Të gjitha këto janë pjesë përbërëse e të qenurit në grup.

Grupi konstant i fëmijëve është parakushti më optimal për këtë. Kjo qëndrueshmëri është ndryshimi i rëndësishëm me shërbimet e kujdesit të fëmijëve.

Fëmijët e moshës parashkollore dëshirojnë që të janë vetëaktiv dhe jo çdoherë të janë të zënë/punësuar. Kështu që fëmija kryesisht e zgjedh vetë lojën dhe aktivitetin e tij. Udhëheqësja e grupit e mbështet dhe e përcjellë aktivitetin/lojën dhe i ofron hapsirë të lirë për mundësitë e zbulimit dhe zhvillimit, por edhe kufij të qartë.

Në grupin e lojës punohet me materiale të ndryshme, ngjyrosin, vizatojnë, gatujnë, bëjnë muzikë dhe këndojnë, bëjnë zhurëm dhe lëvizje, tregohen tregime. Përvoja lozonjare, testimi i këndshëm, bërja e gjërave së bashku janë fokusi i të gjitha aktiviteteve dhe jo prodhimi i produkteve perfekte.

Gjatë gjithë kësaj merren parasysh dëshirat dhe nevojat sipas moshës së fëmijës, kjo do të thotë që oferta në pjesën e lojës dhe kreativitetit janë vullnetare. Fëmija në këtë mënyrë e ka mundësinë të veprojë sipas ritmit të tij personal, të luajë vetëm për vete, të i vëzhgojë të tjerët, të marrë pjesë në ngjarje sipas mënyrës së vet.

Në të kundërtën me parashkolloren, grupi i lojës nuk ka planprogram fix për lojë dhe për mësim.

### **Cilat janë dobitë e grupit të lojës për fëmijën?**

Në një strukturë të sigurtë dhe të menagjueshme grupi i lojës i ofron fëmijës ushtrimin e ndarjes së ngadalshme nga personat më të afërt. I bën hapat e parë në një mjedis të panjohur, kontakti me një person kujdestar/perkujdesës të ri, kontakt me fëmijë të rinjë si dhe hap ndaj më shumë pavarësije dhe i hapur. I zgjeron aftësitë gjuhësore, manuale, mendore, sociale dhe motorike.

Në grupin e lojës fëmija i fiton përjetimet e tija personale të cilat nuk duhet të i ndajë me motrat dhe vëllezërit, gradualisht e bën kalimin nga familja në grupin e madhë në parashkollore.

### **Cilat janë dobitë e grupit të lojës për prindërit?**

Përmes grupit të lojës, prindërit njohtohen me prindërit e fëmijëve moshatarë, krijohet mundësia e kontakteve dhe shkëmbimit të përvojave. Poashtu gjatë kësaj kohe prindërit kane mundësinë të kujdesen për nevojat e tyre personale.